

VENDIM
Nr. 11, datë 8.1.2025

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN DHJETOR 2024,
PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.1.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 26 prot., datë 6.1.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- “FSHU” sh.a. me shkresën nr. 7780 prot., datë 31.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2655 prot., datë 31.12.2024, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin dhjetor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin dhjetor 2024 shoqëria “FSHU” sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- Për përllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), “FSHU” sh.a. është bazuar në blerjet ditore/mujore të saj në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për muajin dhjetor 2024, profilet ditore të prokurara në Bursë, çmimin ditë/orar, si dhe vlerën e faturës ditore.

- Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt), i përllogaritur nga shoqëria për muajin dhjetor 2024 është 14.86 lekë/kwh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rilllogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 14.86 lekë/kwh, ashtu siç është pasqyruar edhe në përllogaritjet e përcjella nga vetë shoqëria.

- Referuar aplikimit të shoqërisë “FSHU” sh.a., rezulton se në çmimin e përllogaritur “FSHU” sh.a. shton edhe kostot e disbalancave të përllogaritura për muajin dhjetor 2024.

- Mbështetur në nenin 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2024, janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike e cila për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, e cila mbështetur në vendimin të Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, vijon të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Kostot administrative, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”, vijnë të jenë 1.06 lekë/kwh.

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive të harkut kohor 27.11.2024–30.12.2024.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2024, përllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin dhjetor 2024</i>			
		<i>Njësia</i>	<i>Çmimi</i>
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	14.86
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.45
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
<i>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA</i>		<i>Lekë/kWh</i>	<i>18.77</i>

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 18.77 lekë/kwh për muajin dhjetor 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2024, prej 18.77 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti